**c)** Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

**d)** Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

**e)** Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ------------ **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

**f)** Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ------------- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

| | |
|---|---|
| **Emri i përfaqësuesit të ofertuesit** | |
| **Nënshkrimi** | |
| **Vula** | |
| **Datë __________________** | |

**Shtojca 1/1.**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant per ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët]*

## FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor**]

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i [**Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

**a)** Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[*shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE*]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

**b)** Ne **[*vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti*)**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[*vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit*]**.

**c)** Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

**ç)** Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

**d**) Norma e fitimit e shprehur në vlere absolute është si më poshtë

| 1 | 2 | 3 |
|---|---|---|
| **Nr.** | **Përshkrimi i mallrave** | **Norma e fitimit** |
| | | |

| | |
|---|---|
| **Emri i përfaqësuesit të ofertuesit** | |
| **Nënshkrimi** | |
| **Vula** | |
| **Datë __________________** | |

| |
|---|
| **Shtojca 2.**<br>*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*<br>**LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE** |

**Data**: ____________________________________

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
___________________________________

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): _________________________________________________

**Monedha**: ____________

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

| *1* | *2* | *3* | *4* | *6* | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Artikulli** | **Përshkrimi i mallit** | **Sasia** | **çmimi per njesi** | **Çmimi total për artikull (*3* x *4X*)** | |
| 1. | | | | | |
| 2. | | | | | |
| 3. | | | | | |
| 4 | | | | | |
| | **Çmimi total (Mallrat)** | | | | _____________ |

| | |
|---|---|
| **Çmimi Neto pa TVSH** | |
| **TVSH (%)** | |
| **Çmimi total me TVSH:** | |
| **Emri i përfaqësuesit të ofertuesit** | |
| **Nënshkrimi** | |
| **Vula** | |

| | |
|---|---|
| **Datë _________________** | |

**Shtojca 3.**

[ *Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

**FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS**

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

*Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra]* si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit/entit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kerkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontrates së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës*].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

**Shtojca 4.**

*(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

**Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

| Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial | Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale | Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni | Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

**VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Përfaqësuesi i Ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shtojca 5.**

[ *Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

# 1. HYRJE

### 1.1. Përfituesi /Autoriteti Kontraktues

**Albpetrol sh.a.**

### 1.2. Historiku

Albpetrol sh.a. është një shoqëri aksionere me 100% të aksioneve të zotëruara nga shteti shqiptar. Selia qëndrore e kompanisë ndodhet në qytetin e Patosit. Në vitin 2014, Albpetrol sh.a. ka hapur dhe një zyrë përfaqësimi në Tiranë. Roli kryesor i shoqërisë është prodhimi dhe tregtimi i produkteve të naftës si dhe monitorimi i Marrëveshjeve Hidrokarbure.

### 1.3. Situata Aktuale në Sektor

Aktualisht Albpetrol sh.a. i ofron punonjësve të saj infrastrukturën dhe shërbimet bazë TIK, të cilat përfshijnë rrjetin kompjuterik lokal dhe internet, infrastrukturen qendrore per ruajtjen dhe perpunimin e te dhenave, komunikimin etj te perbere nga servera, storage dhe pajisje desktop per punonjesit si dhe sistemi GIS i hedhjes, perpunimit dhe ruajtjes se te dhenave gjeohapesinore.

Nga një analizë e të gjithë procedurave dhe proceseve të punës së këtij institucioni, dhe rezultateve nga auditimi i investimeve të deritanishme në fushën e teknologjisë së informacionit, vërehet se ka ende nevojë për investime në fushën TIK në drejtimet e duhura.

Nisur nga ky auditim konstatohet se infrastruktura ekzistuese është e amortizuar dhe e vjetëruar nga pikëpamja e zhvillimeve teknologjike moderne. Shumë prej pajisjeve janë EOL (janë zëvendësuar nga një gjeneratë e re produktesh) dhe pjesa më e madhe e software dhe licencave janë pa suportin e prodhuesit.

Gjithashtu, nisur nga situata aktuale ku sulmet keqdashëse kibernetike janë bërë kaq prezente dhe të shpeshta edhe në vendin tonë janë rekomanduar investime domethënëse në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes në aplikimin e teknologjisë së informacionit.

Këto investime dhe projekte jo vetëm do garantojnë siguri dhe efiçencë por do të kontribuojnë gjithashtu në përmirësimin dhe përshpejtimin e procedurave dhe proceseve të punës dhe të shërbimeve që Albpetrol sh.a. ofron.

## 2. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

### 2.1. Objektivi i Përgjithshëm

Objektivi i përgjithshëm i projektit është përmirësimi i vijueshëm i aktivitetit të operimeve tregtare të përditshme në Albpetrol, me anë të investimeve në teknologjinë e informacionit, më konkretisht në digjitalizimin, unifikimin dhe harmonizimin e procedurave dhe proceseve të punës të Albpetrol.

### 2.2. Qëllimi

Qëllimi i këtij projekti është ristrukturimi dhe rinovimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit të Albpetrol sh.a. si vijon:

- Projektimi dhe implementimi i rritjes dhe përmirësimit të kapaciteteve fizike dhe virtuale të sistemeve server dhe storage në dhomën e serverëve qëndrore dhe dhe në dhomën e serverëve të vazhdueshmërisë së biznesit dhe backup.
- Furnizimin, instalimet fizike si dhe konfigurimet e pajisjeve qendrore të rrjetit që do të ofrohen (Wired dhe Wireless).
- Furnizimin, instalimet fizike si dhe konfigurimet e pajisjeve të rrjetit akeses (Switch-e Aksesi me PoE).
- Konfigurimi i rrjetit dhe shërbimeve.
- Rritja e niveleve të sigurise së sistemeve (Firewall, sistemet antivirus, manaxhimit të dobësive, sigurisë së email, mbrojtjes nga humbja e të dhënave, manaxhimi i perdoruesve).
- Integrimin e pajisjeve dhe software të rinj me pajisjet ekzistuese të rrjetit LAN në godinën qendrore (Switch-e ekzistues).
- Konfigurimin e politikave të sigurisë në perimetrin e jashtëm (WAN edge).
- Rindertimin e rrjetit te brendshem (LAN) dhe konfigurimin e politikave të sigurisë në të gjithë segmentet e perimetrit të brendshëm (Internal LAN).

### 2.3. Rezultatet që duhet të arrihen nga Kontraktori

Operatori ekonomik fitues duhet te realizojë sipas kërkesave teknike të specifikuara në këtë dokument furnizimin, instalimin dhe implementimin e të gjitha zërave të projektit.

Gjithashtu kontraktori duhet të realizojë trajnimin e administratorit lokal si dhe të dorëzojë të gjitha raportet e specifikuara në pikën 6 të këtij dokumenti.

Pas dorëzimit të projektit kontraktori duhet të **kryejë mirëmbajtjen 1 (një) vjeçare të sistemit.**

## 3. SUPOZIMET DHE RISQET

### 3.1. Supozimet e Projektit

Për përfundimin me sukses të këtij projekti, duhet të sigurohet një bashkëpunim i ngushtë midis Albpetrol sh.a. dhe kompanisë fituese të kontratës si dhe vënia në dispozicion e infrastrukturës së nevojshme dhe alokimi i burimeve njerëzore të nevojshme për implementimin e këtij projekti;

- Albpetrol sh.a. do të vërë në dispozicion të operatorit ekonomik të gjitha informacionet lidhur me planimetrinë, konfigurimet e infrastrukturës ekzistuese, dokumentet, rregulloret dhe materialet e nevojshme për implementimin e projektit;
- Informacioni i shkëmbyer mes palëve duhet të mbetet konfidencial;
- Stafi i operatorit ekonomik duhet të jetë i aftë të punojë në një ambient me disiplinë të ndryshme pune;
- Stafet përkatës të autoritetit Albpetrol sh.a. dhe operatorit ekonomik duhet të jenë komunikues dhe të aftë të bashkëpunojnë dhe të gjejnë konsensus;

### 3.2. Risqet

Duke u nisur nga eksperienca është shumë i rëndësishëm komunikimi dhe përcaktimi i qartë i detyrave për kërkesat apo ndryshime që mund të nevojiten gjatë realizimit të kontratës midis palëve. Si faktorë risku mund të përmendim:

- Mungesa e bashkëpunimit të cituar më lart, mund të jetë një faktor që mund të çojë në dështimin e këtij projekti;

- Mos përmbushja e plotë e kërkesave funksionale dhe teknike nga operatori ekonomik;
- Mos dorëzimi në kohë i projektit duke çuar në mosrespektimin e afateve;
- Ndërprerjet e shërbimit gjatë instalimit dhe implementimit të pajisjeve të reja në rrjetin ekzistues;

## 4. QËLLIMI I PUNËS

### 4.1. Të Përgjithshme

Mbështetur në analizën e gjendjes aktuale dhe në kuadër të përmirësimit të vijueshëm të aktivitetit të operimeve tregtare të përditshme në Albpetrol, kërkohet të realizohen investime në teknologjinë e informacionit, me qëllim digjitalizimin, unifikimin dhe harmonizimin e procedurave dhe proceseve të punës të Albpetrol. Zgjidhja që kërkohet për të realizuar projektin përshrkuhet si më poshtë:

- **Realizimi dhe konfigurimi i rrjetit fizik.**
  Ky shërbim duhet të kryhet për të gjithë ndërtesën me 3 kate të Albpetrol sh.a. Në total llogariten 200 poste pune për të cilat duhet realizuar kabllimi, kanalizimi, instalimi i prizave, lidhja në patch panel, testimi, etiketimi etj. Kabllimi duhet të kryhet i tillë që secili post pune të lidhet direkt me pajisjet ‘switch’ të nyjeve të rrjetit, duke shmangur vendosjen e pajisjeve të tjera ndërmjet (cascade). Kjo duhet për përcaktimin e politikave të aksesit nga pajisjet e rrjetit dhe për të shmangur komunikimet paralele, në rast të problemeve që mund të shkaktojë një pajisje e kompromentuar. Instalimet e rrjetit duhet të kenë mbrojtje nga interferencat nga kabllot ose burimet e ndryshme të fuqisë. Planimetria e ndërtesës dhe plani i shpërndarjes do të konsultohen në fazën e planifikimit të projektit.

- **Përmirësimi i sistemi të furnizimit me energji (UPS)**
  Sistemi UPS është i nevojshëm për të mundësuar mbrojtjen ndaj ndërprerjeve të energjisë. Pajisjet aktuale UPS janë të amortizuara, dhe nuk garantojnë suport të mjaftueshëm me energji në rast të ndërprerjeve të furnizimit me energji elektrike nga rrjeti. Dy UPS-të e rinj duhet të jenë të paktën nga 6kVA secili. Pajisjet me nga dy burime ushqimi do të furnizohen nga të dy UPS-të për të mos patur një pikë të vetme dështimi (single point of failure).

- **Server & Storage**
  Pjesë e objektivit të përgjithshëm të këtij projekti është ndërtimi i një infrastrukture të re të bazuar në nyje të virtualizuara që kanë teknologji të fundit të menaxhimit të hapësirave të storage dhe të burimeve procesuese me anë të paisjeve hardware server si dhe licenca në përputhje me nevojat. Zgjidhja që do të realizohet duhet të bazohet në platformën e konvergjuar të infrastrukturës TI në formatin e një blloku standard server x86, që integron:

    - hapësirën e ruajtjes (storage)
    - procesimit (compute)
    - rrjetit (networking)
    - hipervizor-it (hypervisor)
    - metodave të optimizimit të të dhënave (kopjim në kohë reale, kompresim, de-duplikim, etj.)
    - menaxhimin e të dhënave, mbrojtjen e të dhënave dhe aftësite e rikuperimit të tyre.

  Zgjidhja duhet të jetë si më poshtë nëpërmjet një sasie “nyjesh” (node) që të ofrojnë minimumi “redundanci” (redundancy) N+2 në nivel “nyje” (ku $N \geq 2$), me qëllim që të sigurohet ri-shpëndarja e ngarkesës së nyjes së demtuar tek nyjet e tjera aktive.
  Kapaciteti total i “burimeve” të ofruara nga zgjidhja (të para-instaluara dhe të shpërndara në mënyrë simetrike të barabartë në secilën node) duhet të jetë sipas specifikimeve në pikën 11 të dokumentit.
  Serverët fizikë do lidhen me njeri-tjetrin në grup (cluster) për të krijuar mjedisin ku do të ekzekutohen makinat virtuale. Serverët duhet të ofrojnë burime të mjaftueshme hardware për të garantuar shpejtësi në funksionimin e makinave virtuale dhe në ofrimin e shërbimeve si

edhe mundësi për të përballuar të gjithë ngarkesën pa cënuar shërbimet në rast të problemeve me një ose më shumë serverë.
Zgjidhja për sistemin storage duhet të ofrojë një sistem kompakt, me densitet të lartë, me konsum të ulët të hapësirës në kabinet, të zgjerueshëm dhe me performance të lartë, i cili do të operojë me disqe SSD dhe SAS. Lidhja me serverët fizike duhet të realizohet me rrjet optik.

*Paraqitje skematike e zgjidhjes teknike të kërkuar:*




- **Sistem Backup në kasetë dhe Software Backup**
  Një zgjidhje Backup funksionale dhe e besueshme është thelbësore në rastet kur lind nevoja e ringritjes së sistemeve, të cilat mund të bien për arsye nga më të ndryshmet për të garantuar rikthimin e shërbimeve dhe proceseve të biznesit pa humbje në të dhëna. Për këtë qëllim duhen Tape, kaseta dhe software për ekzekutimin e backup dhe restore sipas specifikimeve në pikën 11 të këtij dokumenti.
  Përmes një infrastrukture të dedikuar dhe të kompletuar duhet të realizohet backup i të dhënave pa ndikim në shërbime dhe duhet të arrihet që krahas të dhënave në sistemin storage të ketë një kopje tjetër në kasetë duke ofruar kështu ruajtjen e të dhënave në një media tjetër si edhe mundësinë e ruajtjes në një tjetër vendndodhje.
  Kjo zgjidhje do të ofrojë mbrojtje nga sulmet e sigurisë ransomware dhe rikthim të shpejtë dhe të sigurt të të dhënave deri në nivel skedari.
  Zgjidhja do të instalohet në një server fizik të dedikuar për sistemin e backup.

- **Switch-e SAN**
  Gjithë infrastruktura fizike e përshkruar më lart duke përfshirë edhe infrastrukturën e backup do të lidhet përmes një rrjeti SAN, duke mundësuar për të gjitha pajisjet shpejtësi komunikimi optike, disa rrugë komunikimi, ‘redundacy’ si dhe zgjerueshmëri. Prandaj është e nevojshme blerja, instalimi dhe konfigurimi i 2 Switch-eve SAN.

- **Sistem virtualizimi**
  Mbi këtë infrastrukturë të mbi-konvergjuar duhet të realizohet aplikimi i një shtrese të abstraguar të menaxhimit të virtualizuar në mënyrë të qendërzuar, që të plotësojë këto kushte teknike operacionale:

- Sistemi operativ i virtualizimit duhet të jetë i instalueshëm në pajisje Server që suporton virtualizim në nivel hardware me teknologji bazë x86-64.
- Softueri i Virtualizimit duhet të jetë në gjendje të shpërndajë dhe ekuilibrojë në mënyrë dinamike kapacitetetet procesuese të burimeve të shtresës hardware të datacenterit të virtualizuar, në grupime të ndryshme të këtyre pajisjeve hardware, si dhe të mund të unifikojë kontrollin mbi objektet virtuale (si disk virtual apo makinë virtuale) që mund të jenë ngritur mbi pajisjet fizike.
- Softueri i Virtualizimit duhet të lejojë apo parandalojë që një makinë virtuale të migrojë nga vendodhja aktuale drejt një hosti të caktuar fizik me metodën live migration.
- Softueri i Virtualizimit duhet të sigurojë kernel të integruar në hypervizor softuer për virtualizimin e komponentëve switch, disk, network, migrim, mbrotje të të dhënave, replikim dhe disponueshmeri të të dhënave.
- Softueri i Virtualizimit duhet të mundësojë lidhjen në metodën cluster të serverave të virtualizuar mbi të cilën aplikohet sistemi operativ i virtualizuar (Hypervizor OS).
- Softueri i Virtualizimit duhet të mundësojë filesistemin e përshtatshëm për disqe me madhësi blloku 512e,512n dhe 4Kn.
- Softueri i Virtualizimit duhet të mundësoje mjete softuerike të integruar në shërbimet virtuale VM.
- Softueri i Virtualizimit duhet të mbështesë mekanizmin e migrimit në ambjent ku është aplikuar metoda cluster.

- **Infrastrukturë rrjeti**

  Projekti do të realizojë dhe upgrade të rrjetit ekzistues duke furnizuar pajisje te reja switch (datacenter, aksesi) të përshtatshme për komunikime me nyjet e virtualizimit. Ri-dizenjimi dhe implementimi i upgrade të pajisjeve dhe infrastrukturës së rrjetit do të ofrojë një infrastrukturë moderne, e cila garanton performancën dhe sigurinë e rrjetit në të gjithë segmentet LAN Access, Core dhe Edge/WAN. Specifikimet dhe sasitë për swichet Datacenter, e aksesit, etj. janë në pikën 9 dhe 11 të këtij dokumenti.




*Paraqitje skematike e zgjidhjes në datacenter*

- **Infrastrukturë për rrjetin wireless dhe siguria në rrjet**

  Pjesë e objektivit të përgjithshëm të projektit është dhe implementimi i një zgjidhje të re të infrastrukturës wireless. Një tjetër objektiv është implementimi i një zgjidhje të re për të zhvilluar më tej politikat e sigurisë të infrastrukturës wired si dhe wireless e cila do duhet të

integrohet me infrastrukturën ekzistuese. Gjithashtu, duhet të realizohet integrimi me rrjetin ekzistues për pajisjet Layer 2 si dhe Layer 3.

Një ndër qëllimet kryesore të këtij projekti është zëvëndësimi i infrastrukturës aktuale me një infrastrukturë wireless të re bazuar mbi teknologjinë WIFI-6, e cila duhet të mundësojë performancë më të mirë, kapacitet të lartë dhe funksione të reja duke ofruar një experiencë më të mirë për përdoruesit e rrjetit wireless. Disa nga vecoritë kryesore që duhet të ofrojë zgjidhja teknike për infrastrukturën wireless janë:

- Rritje të sigurisë në ndërfaqen wireless, për përdoruesit dhe pajisjet.
- Integrimi i Infrastrukturës së re Wireless me sistemin e sigurisë për kontrollin e aksesit për autentifikim të sigurt për të gjitha Wireless SSID.
- Implementim i shpejtë i kësaj infrastrukture me wireless kontrollera të cilët mund të instalohen në infratrukturën ekzistuese të Cloud (VMware, HyperV, KVM).
- Akses Point-e të cilët ofrojnë shumë vecori të reja dhe mundësi për tu bërë upgrade në të ardhmen.
- Mundësi për tu automatizuar duke përdorur një set të gjerë të ndërfaqeve standarde API.

Veç të tjerash duhet të mundësohet:

- implementimi i politikave BYOD – Bring Your Own Device;
- Integrimi i Infrastrukturës aktuale AD me zgjidhjen e propozuar mbi sistemin e sigurisë për kontrollin e aksesit;
- prezantimi i politikave të sigurisë për VPN users;
- prezantim dhe konfigurim i politikave të sigurisë për përdoruesit e rrjetit kabllor (Wired users) sipas departamenteve përkatëse;
- autentifikim i sigurt i sensorëve (apo IoT Devices);
- implementimi i portaleve të autentifikimit të sigurt Guest dhe Sponsor permes "HTTPS redirect" etj.
- performancë më të mire;
- nivel sigurie të lartë;
- koleksionim i device Information përmes funksionalitetit të sistemit të sigurisë për kontrollin e aksesit për menaxhimin e aseteve;
- autentifikim i përdoruesve Guest dhe atyre të lidhur me AD permes "HTTPS-SSL enabled portals", BYOD portals për përdoruesit që sjellin pajisjet e tyre në zyrat e korporatës;
- autentifikim i sigurt për përdoruesit Guest përmes Guest portal – Sponsor Portals.

Disa nga vecoritë kryesore që duhet të mundësojë sistemi i sigurisë për kontrollin e aksesit janë si më poshtë:

- Vizibilitet i aseteve të kompanisë
- Aksese të ndryshme sipas kontentit
- Aplikim apo zbatim i politikave të sigurisë mbi aksesin
- Metoda aksesi për përdoruesit Guest me anë të "Guest Portals & Sponsor Portals"
- Funksionalitet BYOD
- Verifikim i automatizuar mbi pajtueshmërinë e pajisjeve
- Politika sigurie aksesi
- TrustSec Group Based Policy – Markim i paketave sipas sistemit të sigurisë për kontrollin e aksesit
- Auditim i pajisjeve
- Koleksionim informacioni rreth pajisjeve të përdorura në korporate – "Profiling"
- Vendosja e politikave të detajuara të sigurisë ne nivel aplikacioni apo regjistrash – "Posture Services"
- Integrim me Active Directory dhe suport per "Multiforest"

- **Siguria**

  Rrjeti i sotëm është më kompleks se kurrë më parë dhe mbrojtja e tij nga sulmet malinje dhe të sofistikuar është një detyrë shumë kritike. Për të mbrojtur pronësinë tonë intelektuale, për të shmangur prishjen e biznesit si dhe mohimin e ofrimit të shërbimeve tona, duhet të sigurojmë në mënyrë proaktive mjedisin tonë teknologjik, në mënyrë që të zbulojmë dhe

ndalojmë me shpejtësi kërcënimet dhe të kundërpërgjigjemi me saktësi, përpara se sulmuesit të jenë në gjendje të shkaktojnë dëme reale dhe materiale. Prandaj, nevojitet një mbrojtje efikase e sistemeve dhe pajisjeve, me anë të rinovimit të infrastrukturës së mbrojtjes dhe sigurisë.
Për këtë qëllim duhet bërë upgrade i pajisjeve firewall në pajisje të reja dhe moderne ku të përfshihet mbrojtja IPS, URL filter, application control, etj, të cilat duhen konfiguruar në grup (cluster) në Albpetrol HQ për më shumë disponueshmëri si dhe 10 copë firewall-e për të mbrojtur komunikimin e Drejtorive me godinën qëndrore.

- **Microsoft Office 365**
  Për të rritur performancën dhe produktivitetin e administratës së Albpetrol sh.a kërkohet të blihen 150 licenca Microsoft Office 365 (Word, Excel, PowerPoint, etj.) së bashku me suportin e prodhuesit për 1(një) vit.

- **Antivirus**
  Çdo lidhje dhe ndërveprim me internetin vë potencialisht në rrezik pajisjet/ rrjetin/ sistemet nga viruset dhe malware (kod që mund të dëmtojë serverat, kompjuterët, laptopët si dhe të dhënat në to). Ky rrezik është real dhe jo pak herë ka dëmtuar sistemet në institucione/organizata të ndryshme në vendin tonë. Si masë proaktive ndaj këtij rreziku krejtësisht potencial është shumë e rëndësishme që të instalohet, përdoret dhe përditësohet rregullisht një sistem antivirus në Albpetrol sh.a. sipas specifikimeve në pikën 11 të këtij dokumenti.

- **Sistem DLP (Data Loss Prevention)**
  Parandalimi i humbjes së të dhënave është një zgjidhje sigurie që identifikon dhe ndihmon në parandalimin e ndarjes, transferimit ose përdorimit të pasigurt ose të papërshtatshëm të të dhënave të ndjeshme. Parandalimi i humbjes së të dhënave (DLP) nevojitet në mënyrë që të identifikohen të dhënat konfidenciale, të gjurmohen ato të dhëna ndërsa lëvizin përmes dhe jashtë ndërmarrjes dhe të parandalojë zbulimin e paautorizuar të të dhënave duke krijuar dhe zbatuar politikat e zbulimit.

- **Sistem për sigurinë e Email**
  Implementimi i një sistemi për sigurinë e postës elektronike ndihmon në mbrojtjen e Albpetrol sh.a. nga kërcënimet kibernetike që përdorin llogaritë e emailit, si p.sh. phishing dhe posta e padëshiruar, për të fituar akses të paautorizuar në rrjet. Siguria e postës elektronike është e rëndësishme sepse emaili me qëllim të keq është një medium që përdoret shpesh për përhapjen e ‘ransomware’, ‘spyware’, lloje të ndryshme malware, sulme të inxhinierisë sociale si phishing ose email phishing dhe kërcënime të tjera kibernetike.

- **Sistem për manaxhimin e dobësive (Vulnerability Management)**
  Menaxhimi i cenueshmërisë përmirëson pozicionin e përgjithshëm të sigurisë së Albpetrol sh.a. duke njohur asetet kryesore dhe ku mund t’i jepet përparësi përpjekjeve për të zvogëluar rrezikun. Duke punuar së bashku me ekipet e tjera të sigurisë, ai ndihmon në parandalimin e aksesit dhe shfrytëzimit të të dhënave nga aktorët e kërcënimit potencial Instalimi i një sistemi të tillë do të rritë nivelet e sigurisë të Albpetrol sh.a.

#### 4.1.1.Hapësira gjeografike që do të mbulohet:
Zyrat qendrore të administratës së Albpetrol sh.a. Patos dhe Drejtoritë.

#### 4.1.2.Grupet e synuara
Nga zbatimi i sitemit, synohet përmirësimi si dhe rritja e sigurisë dhe e shpejtësisë së operimit të strukturave të Albpetrol sh.a.

### 4.2. Detyrat specifike
Më poshtë listohen detyrat specifike që duhet të realizojë Operatori Ekonomik për të përmbushur detyrimet kontraktuale me qëllim implementimin të projektit.

1. Vizitë në site dhe takimi me grupin e punës.
2. Planifikimi i zhvillimit të projektit.
3. Furnizimi me pajisjet dhe licencat e kërkuara.
4. Realizimi i kabllimeve, lidhjeve në patch panel dhe etiketimeve për rrjetin fizik.
5. Testimi i rrjetit fizik.
6. Instalimi dhe testimi i UPS-ve.
7. Instalimi në rack dhe kontrolli për defekte i të gjitha pajisjeve hardware.
8. Upgrade i firmware për të gjitha pajisjet.
9. Instalimet e sistemeve të shfrytëzimit dhe të virtualizimit si dhe ngritja e makinave virtuale.
10. Realizimi i konfigurimeve të pajisjeve.
11. Instalimet dhe përditësimet e sistemeve.
12. Realizimi i konfigurimeve të platformave.
13. Licencimi nga prodhuesit i licencave/softuerëve të furnizuar.
14. Testimet e sistemeve.
15. Trajnimi i administratorit lokal.
16. Përgatitja dhe dorëzimi i dokumentacioni përkatës teknik dhe administrativ.
17. Mirëmbajtja 1 vjeçare e sistemit.

## 5. LOGJISTIKA DHE KOHA

### 5.1. Vendndodhja

Zyrat qendrore të Albpetrol sh.a. Patos dhe Drejtoritë.

### 5.2. Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave

Data e destinuar e fillimit është menjëherë pas lidhjes së kontratës dhe periudha e zbatimit të kontratës do të jetë 6 muaj nisur nga kjo datë për sjelljen e mallrave dhe implementimin.

## 6. RAPORTIMI

### 6.1. Kërkesat e Raportimit

Kontraktuesi do të paraqesë raportet e mëposhtme në shqip, në origjinal dhe në 3 kopje:

- **Raporti Fillestar** duhet të prodhohet pas dy javësh nga fillimi i implementimit. Raporti duhet të përmbajë një analizë të situatës aktuale, zgjidhjen që realizon qëllimin e projektit si dhe me një plan pune të detajuar së bashku me afatet kohore për çdo aktivitet.
- **Drafti i raportit përfundimtar** duhet të dorëzohet jo më vonë se një muaj para përfundimit të periudhës së zbatimit të detyrave.
- **Raporti final** duhet të përfshijë komentet e pranuara nga palët në draft raport. Afati i fundit për dërgimin e raportit përfundimtar është një javë pas marrjes së komenteve në draft raportin përfundimtar. Raporti duhet të përmbajë ecurinë e implementimit, specifikat e procesit, manualin e përdorimit të përdoruesit etj. Analizat e detajuara që i mbështësin rekomandimet do të prezantohen në anekset në raportin kryesor. Raporti përfundimtar duhet të sigurohet së bashku me faturën përkatëse.

### 6.2. Dorëzimi dhe Miratimi i Raporteve

Raporti i përmendur më sipër duhet t'i dorëzohet Grupit të Punës të Projektit të identifikuar në kontratë. Grupi i Punës së Projektit është përgjegjës për aprovimin e raporteve.

## 7. GARANCIA

Periudha e garancisë gjatë së cilës Operatori Ekonomik do të monitorojë dhe riparojë problemet që mund të shfaqen duhet të jetë **1 vit**, pas dorëzimit të projektit.

## 8. AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT

Data e fillimit do jetë data e nënshkrimit të kontratës dhe periudha e implementimit të kontratës do jetë 6 muaj duke filluar nga kjo datë.

| Emërtimi i fazës /Periudha kohore (ne muaj) | | M1 | M2 | M3 | M4 | M5 | M6 | M7-M18 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Planifikimi i projektit | x | | | | | | |
| 2 | Lëvrimi i pajisjeve hardware dhe licencave | | x | x | x | x | | |
| 3 | Instalime, konfigurime | | | x | x | x | x | |
| 4 | Testimi | | | | | x | x | |
| 5 | Trajnimi i administratorit | | | | | | x | |
| 6 | Marrja ne dorezim | | | | | | x | |
| 7 | Garancia | | | | | | | x |

## 9. TABELA E BUXHETIT TË PROJEKTIT

| Nr. | Zëri | Sasia | Vlera për Njësi | Vlera Totale |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Realizimi i rrjetit fizik (post pune) | 200 | | |
| 2 | Sistem UPS | 2 | | |
| 3 | Sistem Storage | 1 | | |
| 4 | Serverë | 3 | | |
| 5 | Sistem Backup në kasetë | 1 | | |
| 6 | Software Backup | 1 | | |
| 7 | Switch-e SAN | 2 | | |
| 8 | Sistem Virtualizimi | 1 | | |
| 9 | Cluster Switch Data Center | 4 | | |
| 10 | Cluster Switch Access | 5 | | |
| 11 | Switch Access PoE+ | 1 | | |
| 12 | Cluster Firewall me IPS, URL Filter | 2 | | |
| 13 | Firewall për lidhjen e sigurt të Drejtorive | 10 | | |
| 14 | Kontrollues Wireless | 1 | | |
| 15 | Access Points | 20 | | |
| 16 | Sistem për menaxhim aksesi përdoruesish | 1 | | |
| 17 | Microsoft 365 | 150 | | |
| 18 | Sistemi AntiVirus | 180 | | |
| 19 | Sistem per parandalimin e humbjes së të dhënave (Data Loss Prevention) | 180 | | |
| 20 | Sistemi i menaxhimit të dobësive | 1 | | |
| 21 | Sistemi i Sigurise së Email | 150 | | |
| 22 | Implementim, konfigurim, trajnim | 1 | | |
| **KOSTO TOTALE (PA TVSH)** | | | | |

## 10. MIRËMBAJTJA

Marrëveshja e shërbimit të mirëmbajtjes së hardware dhe sistemeve do të jetë për një periudhë 1 vjecare, në përputhje me dispozitat e VKM-së Nr. 710, datë 21 gusht 2013, "Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit", të ndryshuar.

**Shërbimet e Mirëmbajtjes**

Kompania duhet të ofrojë shërbime të mirëmbajtjes sipas kërkesës së përshkruar më poshtë:

- Shërbime të mirëmbajtjes parandaluese. Operatori ekonomik duhet të ndërmarrë, në mënyrë periodike një herë në muaj, Shërbime të Mirëmbajtjes Parandaluese për të gjitha software-et dhe hardware-et. Shërbimet Parandaluese, janë shërbime proaktive të cilat do të mundësojnë detektimin në kohë të problematikave, dhe do mundësojnë ndërmarrjen në kohë të hapave rekuperuese, për të mos patur ndërprerje të shërbimit.

- Shërbime Riparimi në vendndodhje (mjediset e autoritetit kontraktor/përfituesit) Operatori ekonomik duhet të jetë e disponueshme gjatë intervalit kohor, nga e Hëna në të Premte, 8:30 x 17:00 , për të ofruar Shërbime të Riparimit në përgjigje të " Alarmeve Madhore" të raportuara nga personeli i autorizuar ("Emergency On-Call Hours"). Për këtë qëllim, me termin Alarm Madhor do të kuptohet parashtrimi i kërkesës për Shërbime Riparimi të ndërmarra në rast të keqfunksionimit të softwareve apo hardware të mbuluara, që i pengon ato të operojnë në përputhje me specifikimet dhe shkaktojnë ndërprerje të sistemit.

  (i) Njoftimi dhe Njohja e Alarmeve Madhore. Personat përgjegjës do të njoftojnë operatorin ekonomik me telefon, postë elektronike ose duke sinjalizuar nëpërmjet ndonjë ndërfaqeje web të vënë në dispozicion, dhe do të presë të kontaktohet nga operatori ekonomik me telefon, gjatë "Emergency On-Call Hours". Operatori ekonomik duhet të kontaktojë personelin përgjegjës dhe të konfirmojnë marrjen e Alarmit Madhor brenda 30 minutave nga marrja e njoftimit nga personeli i autorizuar.

  (ii) Përgjigja ndaj Alarmeve Madhore. Nëse operatori ekonomik nuk mund të përcaktojë shkakun e defektit nga komunikimi me personelin e autorizuar, atëherë ai duhet të dërgojë një Teknik Shërbimi pranë Autoritetit Kontraktor brenda intervalit kohor prej 4 orësh nga momenti i marrjes së njoftimit për Alarm Madhor. Me të mbërritur, tekniku i kompanisë do të mbështetet me asistencë nga personeli i autorizuar dhe do t'i jepet liri veprimi në mjediset dhe sistemet e mbuluara, i shoqëruar dhe survejuar nga personeli i autorizuar, për të filluar menjëherë procedurat e diagnostikimit dhe riparimit.

  (iii) Veprimtaritë e Diagnostikimit dhe Riparimit. Me të mbërritur në vendndodhje, tekniku i shërbimit duhet të fillojë procedurat e diagnostikimit dhe riparimit. Këto veprimtari duhet të vazhdojnë deri sa (a) Alarmi madhor të jetë korrektuar ose të jetë "zgjidhur në mënyrë të tërthortë", (b) tekniku të jetë zëvendësuar nga një person tjetër, (c) Operatori ekonomik të përcaktojë se problemi i raportuar nuk është shkaktuar nga ndonjë keq funksionim i Sistemeve të mbuluara ose (d) Operatori ekonomik arrin në konkluzion që diagnostikimi ose korrektimi i mëtejshëm mund të shtyhet deri në mbërritjen e pjesëve të këmbimit.

Operatori ekonomik fitues duhet të dokumentojë çdo veprim, duke paraqitur gjendjen para dhe pas ndërhyrjeve si dhe duhet të marrë aprovimin paraprak për çdo ndërhyrje. Palët e përfshira duhet të krijojnë një axhendë periodike kontrollesh si më poshtë:

1. **Kontrolle Mujore**
   - Testim/kontroll i kompletuar i pjesëve më kritike të infrastrukturës.
   - Kontroll i detajuar i gjithë log-eve hardware/software.
   - Rishikim i të dhënave mbi përformancë e serverave.
   - Kontroll i funksionaliteteve të sistemit.
   - Kontroll i statistikave të hapësirave server/storage (Hapësira e përdorimit të HDD-ve).
   - Kontroll i statistikave për sistemet.
   - Kontroll i pajisjeve për probleme.
   - Rekomandime për upgrade të mundshme hardware.

# 11. SPECIFIKIME DHE KËRKESAT TEKNIKE

## 11.1. Realizim i rrjetit fizik (post pune)

Rrjeti do të jetë sipas topologjisë 'extended-star'. Ndarja e strukturës së kabllimit në godinë do të jetë në tre zona. Zonat janë ndarje për etiketimin e patch paneleve. Përkatësisht zonat do të jenë:

Zona 1 (Z1): Kati 1

Zona 2 (Z2): Kati 2

Zona 3 (Z3): Kati 3

Planvendosja e kateve do të jetë si në planimetrinë bashkëngjitur këtij dokumenti. (e gjeni si dokument më vete të ngarkuar në SPE)

Nyjet e rrjetit Z1, Z2 dhe Z3 do kenë patch panele me porta të mjaftueshme për numrin e posteve të secilës nga zonat. Patch panelet do të jenë të vendosura në rack-e që do të pozicionohet sipas përcaktimit të Albpetrol.

Instalim, kabllim set-i nënkupton tërësinë e medias së transmetimit, kabëll Cat.5 Class E, porta RJ45 për secilin postacion. Planvendosja e portave është e shprehur në planimetrinë bashkëngjitur.

Shpërndarja në zona të kryhet me anë të kanalinave. Të gjitha pajisjet e infrastrukturës, switch-et, panelet patch, PDU, plates do të instalohen në rack me dimensione të përshtatshme për të vendosur të gjitha pajisjet.

**INSTALIM, KABLLIM**

- Kablli nuk duhet të tërhiqet nën ngarkesë të tepruar, të mos jetë i tendosur.
- Gjatë tërheqjes të shmanget dëmtimi i kabllit me anë të ngërçeve, duke u përdredhur përgjatë boshtit të vet duke u bllokuar, etj.
- Mundësisht kabllo duhet të vendoset në kanalin për të shmangur tërheqjen nën tension.
- Kthesat e kabllove duhet të mbahen në minimum 25 mm.
- Gjatë procesit të instalimit, instaluesit do të inspektojnë vizualisht komponentët e kabllove dhe pajisjeve lidhëse për dëmtime. Nëse konstatohet një dëm i tillë të zëvendësohen menjëherë.
- Të gjitha portet e patch panelit duhet të etiketohen qartë me anë të etiketave të shtypura të siguruara në mënyrë të përshtatshme (etiketat e shkruara me dorë nuk janë të pranueshme).
- Të gjithë portat në postacione duhet të etiketohen qartë me anë të një etikete të shtypur të siguruar në mënyrë të përshtatshme.
- Të gjitha skemat e etiketimit duhet të konfirmohen me përfaqësuesin e duhur të IT para se të aplikohen.
- Mund të integrohet në mbështetëse të kanaleve plastike.
- Kanalinat e jashtme duhet të jenë PVC.
- Suportet e portave të rrjetit duhet të vendosen mbi kanalinat.

### 11.2. UPS i Montueshëm në Rack

| **Karakteristika minimale teknike** | |
|---|---|
| **Formati** | UPS i montueshëm në kabinet (rack). Aksesorët e montimit të përfshirë. |
| **Fuqia në dalje** | 6000VA / 5400 Watts |
| **Tensioni në hyrje** | 220, 230, 240 V<br>50/60 Hz |
| **Nderfaqja hyrese** | IEC 60309 332P6 ose 3 tela ose ekuivalente |
| **Nderfaqja dalese** | (min. 4) IEC 60320 C13; (min. 4) IEC 60320 C19; |
| **Porte dhe program menaxhimi** | Po |
| **Kalim by-pass ne rast problemi** | Po |
| **Tipi i baterisë** | Lead acid |
| **Estimated battery runtime** | ≥ 3 min me ngarkesë 100% |
| **Kabujt e lidhjes** | Për të gjitha portat |
| **Garancia** | Minimumi 1 vit, nga prodhuesi. |

## 11.3. Sistem Storage

| Karakteristika minimale teknike | |
|---|---|
| **Formati** | I montueshëm në kabinet (rack). Aksesorët e montimit të përfshirë. |
| **Pa SPOF (Single Point of Failure)** | Sistemi Storage nuk duhet të ketë asnjë komponent SPOF (*Single Point of Failure*). Të gjithë komponentët duhet të jenë redundant-ë, përfshirë controller-ët (të paktën dy), memorien cache, blloqet e ushqimit (të paktën dy), ventilimin, etj. |
| **Arkitektura** | Controller-ët duhet të jenë plotësisht aktive-aktive. |
| **Memoria Cache** | Sistemi Storage duhet të ofrojë minimumi 32 GB memorie cache për controller, 64 GB memorie cache ne total. |
| **Lidhja e host-eve** | Sistemi Storage duhet të ofrojë minimumi tetë dalje FC 16 Gbps (katër për controller) për lidhje me host-et. |
| **Disqet dhe mbrojtja RAID** | Sistemi Storage duhet të pranoje disqe SSD, SAS dhe NL SAS.<br>Sistemi Storage duhet të ofrojë mbrojtje RAID 1, 5 dhe 6. |
| **Kapaciteti dhe zgjerimi** | Sistemi Storage duhet të ofrohet me:<br>60 TB kapacitet Raw duke përdorur disqe të ndara si më poshtë:<br>Disqe SSD: ~40TB, Disqe SAS 10k: ~20TB;<br>Sistemi Storage duhet të pranojë shtimin e kapacitetit min. 400 ose më shumë disqe. |
| **Mirëmbajtja** | Sistemi Storage duhet të pranojë upgrade të firmware-it online, pa rënie të shërbimeve për të dy controller-ët dhe disqet. |
| **Konfigurimi / manaxhimi** | Sistemi Storage duhet të ofrojë ndërfaqe GUI dhe CLI për konfigurimin dhe manaxhimin.<br>Ndërfaqja e manaxhimit duhet të ofrojë monitorim të performancës në kohë reale. |
| **Funksionalitete të përfshira** | Sistemi Storage duhet të përfshijë licencë për Thin Provisioning, Internal Virtualization, Tiering, FlashCopy, Compression & Deduplication. |
| **Garancia** | Minimumi 1 vit, nga prodhuesi. |

## 11.4. Serverë

| Karakteristika minimale teknike | |
|---|---|
| **Formati** | Server i montueshëm në kabinet (rack) 1U/2U. Aksesorët e montimit të përfshirë. Krahu per manaxhimin e kabllove i përfshirë. |
| **Procesorët** | 2 (dy) proçesorë multi-core, me min. 16 core ose ekuivalente me 30,000 pikë sipas www.cpubenchmark.net. |
| **Memorie (RAM)** | Serveri të përfshijë të paktën 256GB DDR4 ECC.<br>Memoria duhet të jetë e zgjerueshme deri të paktën 3TB. |
| **Kontrolleri RAID** | Serveri duhet të jetë i pajisur me kontroller RAID SAS 12Gb me 2GB Cache të dedikuar dhe të mbrojtur me bateri ose menyrë tjeter.<br>Kontrolleri duhet të suportojë mbrojtje Hardware RAID 0, 1, 5, 6, 10.<br>Kontrolleri duhet të suportojë disqe SATA, SAS, etj. |
| **Storage i brendshëm** | 2 HDD “hot pluggable” min. 480GB SSD, 2.5” Mixed Use të përfshira.<br>Serveri duhet të suportojë deri në minimumi 8 HDD/SSD. |
| **Dalje Ethernet** | 4 dalje 10Gb dhe 1 portë dalje e dedikuar per manaxhimin. |
| **Lidhja FC me Storage** | 2 dalje FC 16Gbps për lidhje me Storage. |
| **Ushqimi** | Redundant, “hot pluggable” . |

| Karakteristika minimale teknike | |
|---|---|
| **Sistemet e Shfrytëzimit dhe Virtualizimit** | Serveri duhet të suportojë sistemet Microsoft Windows Server dhe Microsoft Hyper-V Server, VMware dhe Linux. |
| **Lincenca të përfshira** | Operatori Ekonomik duhet së bashku me Server të ofrojë dhe licencë Microsoft Windows Server 2022 Standard Edition duke licencuar të gjithe core-t e procesorëve fizikë. |
| **Garancia** | Minimumi 1 vit, nga prodhuesi |

## 11.5. Sistem Backup në Kasetë

### 11.5.1 LTO-8 Tape Library

| Karakteristika minimale teknike | |
|---|---|
| **Modeli** | LTO – 8 Tape Library me ngarkim automatik të deri në 24 kaseta.<br>1 (një) ndërfaqe RJ-45 për manaxhim.<br>Aksesorët për montimin në rack të jenë të përfshirë. |
| **Driver** | 1 Drive LTO-8 me ndërfaqe FC 8Gbps. |
| **Kapaciteti** | Kapaciteti total i rezervuar 288 TB.<br>Raporti i kompresimit 2.5:1. |
| **Formati i suportuar** | LTO 8, LTO 7, LTO 6 |
| **Kaseta të përfshira** | 24 kaseta LTO 8 (30TB, RW), 2 kaseta për pastrim (cleaning) LTO Drive. |
| **Garancia** | Minimumi 1 vit, nga prodhuesi |

### 11.5.2 Server për backup

| Karakteristika minimale teknike | |
|---|---|
| **Formati** | Server i montueshëm në kabinet (rack) në format min. 1U. Aksesorët e montimit të përfshirë. Krahu per manaxhimin e kabllove i përfshirë. |
| **Procesorët** | 1 (nje) proçesor multi-core, me min. 16 core ose ekuivalente me 25,000 pikë sipas www.cpubenchmark.net. |
| **Memorie (RAM)** | Serveri të përfshijë të paktën 128GB DDR4 ECC.<br>Memoria duhet të jetë e zgjerueshme deri të paktën 1TB. |
| **Kontrolleri RAID** | Serveri duhet të jetë i pajisur me kontroller RAID SAS 12Gb me 2GB Cache të dedikuar dhe të mbrojtur me bateri ose mënyrë tjetër.<br>Kontrolleri duhet të suportojë mbrojtje Hardware RAID 0, 1, 5, 6, 10.<br>Kontrolleri duhet të suportojë disqe SATA, SAS, etj. |
| **Storage i brendshëm** | 2 HDD “hot pluggable” min. 480GB SSD, 2.5” të përfshira.<br>Serveri duhet të suportojë deri në minimumi 8 HDD/SSD. |
| **Dalje Ethernet** | 4 dalje 1Gb dhe 1 dalje e dedikuar për manaxhimin. |
| **Lidhja FC me Storage** | 2 dalje FC 16Gbps për lidhje me Storage dhe Tape Library. |
| **Ushqimi** | Blloqet e ushqimit Redundante dhe “hot pluggable”. |

| Karakteristika minimale teknike | |
|---|---|
| **Sistemet e Shfrytëzimit dhe Virtualizimit** | Serveri duhet të suportojë sistemet Microsoft Windows Server dhe Microsoft Hyper-V Server, VMware dhe Linux. |
| **Manaxhimi** | Proçesor i dedikuar manaxhimi që të ofrojë mundësi monitorimi dhe manaxhimi në distancë, njoftime "pre-failure", etj. |
| **Garancia** | Minimumi 1 vit, nga prodhuesi |

## 11.6. Software Backup

| Karakteristika minimale teknike | |
|---|---|
| **Numri i instancave** | 20 instanca |
| **Backup** | Mundësi backup në nivel makine virtuale dhe fizike. Mundësi backup inkremental të përhershëm, pa pasur nevojë për backup-e të plotë periodik. Deduplikim dhe kompresim të përfshirë.<br>Mundësi për ruajtjen dhe rikthimin e të dhënave në nivel imazhi, i cili optimizon transferimin e të dhënave. |
| **Replication** | Mundësi replikimi të makinave virtuale. Mundësi replikimi direkt nga backup-et e makinave virtuale.<br>Mundësi testimi i backup-eve të makinave virtuale dhe replikimin e tyre përpara se t'i riktheje ato në punë. |
| **Recovery** | Rikthim i makinave virtuale në host-in origjinal ose në host tjetër. Mundësi për të ngritur shërbimet shpejt duke ngritur makinën virtuale direkt nga backup.<br>Mundësi recovery në nivel file.<br>Mundësi per lëvizje të kasetave ndërmjet librarive. |
| **Manaxhimi** | Manaxhim të centralizuar për platforma të ndryshme (makina fizike dhe virtuale).<br>Suport për Vmware dhe Hyper-V. Konsolë manaxhimi e instalueshme më vete nga server i backup. |
| **Integrimi** | Mundësi integrim në nivel Storage.<br>Mundësi integrim me pajisje Tape për ruajtjen e backup. |
| **Monitorim, Raportim dhe Analiza** | 24/7 monitorim inteligjent dhe raporte gjithëpërfshirëse |
| **Garancia** | Minimumi 1 vit |

## 11.7. Switch-e SAN

| Karakteristika minimale teknike | |
|---|---|
| Forma Fizike | Rack mounted, 1 rack unit, aksesorët e përfshirë |
    - duhet të parandalojë ekzekutimin e pwrditwsimeve të paautorizuara që mund të ndryshojnë aplikacionet ekzistuese.
    - duhet të ketë mundësinë e përcaktimit të aplikacioneve të besuara, të cilave u lejohet të kryejnë përditësime.
    - duhet të parandalojë ekzekutimin e programeve, script-eve dhe librarive tw paautorizuara.

***Enkriptimi i diskut***

Zgjidhja duhet të ketë mundësinë

- të zgjedhë enkriptimin e të gjithë disqeve, vetëm të diskut të startimit (boot), të gjithë disqeve përveç diskut boot, particionin e dëshiruar, etj.

- të enkriptojë në mënyrë transparente diskun pa penguar përdoruesit dhe pa ndikuar në performancën e sistemit.
- të kontrollojë aksesin, të imponojë “strong access control” nëpërmjet autentikimit Pre-Boot.
- të kryejë menaxhim në distancë, të suportojë Intel Active Management Technology (Intel AMT).
- e funksionit “recovery” kur sistemi nuk arrin të rindizet ose sistemi i tij Pre-Boot (PBFS) është i korruptuar.
- të suportojë disqet vetë-kriptuese, TPM 2.0 në sistemet Windows 8, 10 dhe më lart UEFI, në mënyrë që të sigurojë autentifikimin e platformës pa pasur nevojë për autentikim Pre-Boot (PBA).

### 11.19. Sistem per parandalimin e humbjes së të dhënave (Data Loss Prevention)

| **Data Loss Prevention** | |
|---|---|
| **Data Loss Prevention (DLP)** | Sistem i mbrojtjes së informacionit (DLP) + Suport |
| **Aftësitë e avancuara të mbrojtjes** | - Zgjidhja duhet të përfshijë mbrojtjen e të dhënave në stacionet e punës përmes agjentëve ‘DLP’ dhe kontrollin e zbulimit dhe rrjedhjeve të të dhënave në të gjitha kanalet e mundshme.<br>- Zgjidhja duhet të ketë një mundësi të integruar të shpërndarjes së centralizuar të agjentëve dhe menaxhimit të agjentëve përmes një kosole të unifikuar të menaxhimit.<br>- Zgjidhja duhet të suportojë minimalisht veprimet e mëposhtme në rastin e disa manipulimeve të të dhënave të ndjeshme, p.sh. incidente:<br>• pa reagim,<br>• bllokim,<br>• zhvendosje e skedarit në një vend të sigurt,<br>• duke kërkuar justifikim,<br>• menaxhimin e të drejtave,<br>• vendosje në karantinë,<br>• etiketimi,<br>• ‘fingerprint’ (fjalë kyçe) të përmbajtjes,<br>• hapja e një incidenti ‘DLP’ që shfaqet në panelin e menaxhimit dhe në raporte<br>• njoftimi i përdoruesit, përshkallëzimi i incidentit<br>• ruajtja e të dhënave/skedarit origjinal - ruajtja e provave<br><br>- Zgjidhja duhet të ketë një aftësi të integruar për të zbuluar dhe bllokuar transmetimin e të dhënave nëpërmjet aplikacioneve të postës elektronike (p.sh. Microsoft Outlook).<br>- Zgjidhja duhet të ketë një aftësi të integruar për të zbuluar dhe bllokuar transmetimin e të dhënave në të ashtuquajturat depo të të dhënave cloud (p.sh. Dropbox).<br>- Zgjidhja duhet të ketë një aftësi të integruar për të zbuluar dhe bllokuar transmetimin e të dhënave nëpërmjet protokolleve HTTP/HTTPS përmes përdorimit të shfletuesve të internetit (p.sh. Mozilla Firefox ose Google Chrome).<br>- Klasifikimi duhet të jetë fleksibël dhe të përfshijë fjalorë, shprehje të rregullta dhe algoritme të vlefshmërisë, dokumente të regjistruara dhe suport për zgjidhjen e klasifikimit të dokumenteve nga palë të treta.<br>- Zgjidhja duhet të ketë një aftësi të integruar për të zbuluar dhe bllokuar printimin e çdo dokumenti të dërguar në printerin lokal ose të rrjetit.<br>- Zgjidhja duhet të ketë një opsion të integruar për të bllokuar funksionin "Print Screen" në sistemet operative të suportuara të Windows, në momentin kur hapet/shfaqet një dokument që përmban informacion sensitiv; në të kundërt përdoruesi mund të përdorë funksionin "print screen". (kur dokumenti nuk përmban të dhëna të ndjeshme). |

| | |
|---|---|
| | - Zgjidhja duhet të ketë aftësinë për të rregulluar mesazhin paralajmërues të përdoruesit (njoftim), i cili rrit ndërgjegjësimin e përdoruesit dhe e përfshin atë në procesin e ndërmjetësimit në incident.<br>- Agjenti në kompjuterët e mbrojtur duhet të jetë plotësisht funksional edhe kur kompjuterët nuk janë të lidhur me rrjetin kompjuterik të klientit (modaliteti offline).<br>- Zgjidhja duhet të jetë në gjendje t'i kërkojë përdoruesit për arsyetim gjatë kryerjes/dërgimit të të dhënave.<br>- Agjenti në stacionin e punës duhet të mbështesë funksionalitetin e Ndërrimit të Shpejtë të Përdoruesit 'Fast User Switching' në një mjedis Windows OS me shumë përdorues.<br>- Zgjidhja duhet të ketë mundësinë e integrimit standard me zgjidhje për enkriptimin e të dhënave.<br>- Zgjidhja duhet të ketë një aftësi të integruar për shënimin automatik dixhital të skedarëve ('fingerprint' të përmbajtjes) në lidhje me cilin aplikim ose aplikacion në ueb ka krijuar skedarin ose nga cila depo (repository) është shkarkuar skedari. Rregullat/politikat e sigurisë DLP duhet të jenë në gjendje të zbatohen bazuar në etiketën.<br>- Zgjidhja duhet të ketë një aftësi të integruar për të trashëguar etiketën dixhitale të skedarit ('fingerprint' të përmbajtjes) kur kopjoni ose zhvendosni përmbajtje të ndjeshme në një skedar tjetër në mënyrë të tillë që gjatë këtij veprimi përmbajtja që përsëritet ose zhvendoset të analizohet dhe në rast të njohjes, një etiketë duhet të caktohet automatikisht (fingeprint). Politikat e sigurisë DLP duhet të jenë në gjendje të zbatohen bazuar në etiketa.<br>- Zgjidhja duhet të ketë, nëpërmjet punës së një agjenti, mbështetje të integruar për skanimin, analizimin dhe vendndodhjen e të dhënave (skanim zbulimi) në postin e punës të përdoruesit, i cili pas gjetjes duhet të ketë mundësinë minimale të veprimeve të mëposhtme:<br>• raportimi i incidentit në panelin e menaxhimit të sistemit DLP,<br>• Mbledhja e skedarëve, që nënkupton kopjimin e skedarit të vendosur në një vend të veçantë dhe mbajtjen e provave për analizë dhe përpunim të mëtejshëm.<br><br>- Zgjidhja duhet të ketë një mundësi për të rritur ndërgjegjësimin e përdoruesve përmes mesazheve dhe paralajmërimeve në stacionet e tyre të punës, duke i përfshirë ata në procesin e ndërmjetësimit.<br>- Zgjidhja duhet të mbështesë integrimin me DRM (Digital Rights Management), të paktën, MS AD RMS. |
| **Menaxhim i centralizuar** | - Mundësi menaxhimi nga On-Prem ose SaaS (Software-as-a-Service) për politikën e thjeshtuar dhe menaxhimin e incidenteve.<br>- Mundësi për të përdorur politika të shumta dhe grupe të rregullave të ripërdorshme për të përcaktuar politikat 'DLP' në të gjithë organizatën dhe të ndihmojnë në krijimin e<br>Politikave sipas zyrës, departamentit, rregulloreve etj.<br>- Granularitet të zgjeruar në menaxhimin e incidenteve, të cilat mund të kërkojnë/filtrojnë/shikojnë për çdo incident (për shembull, numrin serial të pajisjes, emrin e skedarit, grupet, etj.).<br>- Aftësi të centralizuara të monitorimit dhe auditimit të ngjarjeve.<br>- Kontrolli i aksesit të jetë i bazuar në role (ndarje e detyrave) për menaxhimin e politikave, si dhe rishikimin e incidenteve.<br>- Ndërfaqja e menaxhimit duhet të jetë lehtësisht e menaxhueshme. |
| **Platformat e suportuara** | Windows 7, 8, 8.1, 10, 11 (32 & 64 bit);<br>Windows Server 2012, 2012 R2, 2016, 2019; etj |
| **Suporti** | 1 vit |
| **Licensimi** | Të jetë i licensuar për 400 përdorues |

## 11.20. Sistem për Manaxhimin e Dobësive (Vulnerability Management)

**Veçoritë**

- Të mundësojë paraqitjen vizuale të hartës së rrjetit me paraqitje grafike të hostit;
- Të identifikojë se cilat OS, porta, shërbime dhe certifikata janë në secilën pajisje në rrjet;
- Të organizojë hostet që të përputhen me strukturën e biznesit - p.sh., sipas vendndodhjes, rajonit, departamentit, etj.;
- Të kontrollojë se cilët host-e mund të skanohen nga cilët përdorues;
- Të monitorojë vazhdimisht perimetrin për ndryshime të papritura me shërbim opsional për monitorim të vazhdueshëm;
- Të etiketojë në mënyrë dinamike asetet për të kategorizuar automatikisht hostet sipas atributeve, si adresa e rrjetit, portat e hapura, OS, softueri i instaluar dhe dobësitë e gjetura;

**Skanim për dobësi kudo, me saktësi dhe efikasitet**

- Të selektojë hostet e synuar sipas adresës IP, grupit të aseteve ose etiketës së aseteve;
- Të skanojë manualisht, sipas një orari të përcaktuar ose vazhdimisht;
- Të skanojë në mënyrë të sigurtë pas firewall me «Skaner Appliances», të menaxhuara nga distanca nga Prodhuesi;
- Të skanojë rrjete komplekse të brendshme, si dhe me hapësira të mbivendosura (overlapping IP) të adresave IP private;
- Të ketë shkallë maksimale saktësie « Six Sigma », duke eleminuar maksimalisht rezultatet false;
- Të ruajë informacionin e konfigurimit jashtë perimetrit me gjurmë të sigurta auditimi;

**Identifikimi dhe dhënia e përparësisë së rreziqeve**

- Të gjurmojë dobësitë me kalimin e kohës: siç shfaqen, rregullohen ose rishfaqen;
- Të monitorojë certifikatat e vendosura në të gjithë rrjetin, duke shfaqur se çfarë do të skadojë, në cilat hoste përdoren, cila është madhësia e tyre kryesore dhe nëse ato lidhen apo jo me ndonjë dobësi;
- Të vendosë çështjet kritike në kontekst me Prodhuesin, të përditësojë vazhdimisht bazën e njohurive (Knowledge Base);
- Të ekzaminojë dobësitë e rrjetit me kalimin e kohës, në nivele të ndryshme detajesh,
- Të parashikojë se cilët hoste janë në rrezik për sulmet e «Ditës Zero» me analizuesin opsional të riskut Zero-Day nga Prodhuesi;

**Korrigjimi i dobësive**

- Të krijojë dhe caktojë automatikisht biletat e riparimit sa herë që gjenden dobësi;
- Të mundësojë raporte të konsoliduara se cilët hoste kanë nevojë për cilat korrektime;
- Të ketë mundësi integrimi me sistemet e biletave të TI-së të palëve të treta;
- Të menaxhojë përjashtimet kur një dobësi mund të jetë më e rrezikshme për t'u rregulluar sesa për ta lënë pa rregulluar;
- Të mundësojë që përjashtimet mund të vendosen që të skadojnë automatikisht pas një periudhe kohe për rishikim të mëvonshëm;

**Raporte të përshtatura**

- Të krijojë raporte të ndryshme për audienca të ndryshme, nga tabelat e rezultateve për drejtuesit, deri te analizat e detajuara për ekipet e TI-së;
- Të dokumentojë që ndiqen politikat dhe që gabimet rregullohen;
- Të sigurojë kontekst dhe njohuri për çdo cënueshmëri, duke përfshirë tendencat, parashikimet dhe zgjidhjet e mundshme;
- Të ndjekë progresin e vazhdueshëm ndaj objektivave të menaxhimit të cënueshmërisë;
- Të ndajë të dhënat e fundit me sistemet ‘GRC’ dhe aplikacione të tjera nëpërmjet API-ve të bazuara në XM;

**Objektivat kryesore të VM**

- Të mbajë një bazë të dhënash të **kompjuterëve** dhe pajisjeve të rrjetit – aseteve harduerike.
- Të përpilojë një listë të softuerit të instaluar – asetet e softuerit.
- Të ndryshojë një konfigurim të softuerit për ta bërë atë më pak të ndjeshëm ndaj sulmeve.
- Të identifikojë dhe rregullojë defektet në softuerin e instaluar që ndikojnë në sigurinë.
- Të paralajmërojë për shtimet e pajisjeve, portave ose softuerëve të rinj në bazat e të dhënave për të lejuar një analizë të sipërfaqes së sulmit të ndryshuar dhe për të zbuluar sulme të suksesshme.
- Të tregojë fluksin më efektiv të punës për korrigjimin dhe përditësimin e pajisjeve për të penguar sulmet (të tilla si malware, bot etj.).
- Të mundësojë zbutjen dhe menaxhimin efektiv të rreziqeve të sigurisë.
- Të dokumentojë gjendjen e sigurisë për auditimin dhe pajtueshmërinë me ligjet, rregulloret dhe politikat e biznesit.
- Të përsërisë vazhdimisht hapat e mëparshëm për të siguruar mbrojtjen e vazhdueshme të sigurisë së rrjetit.

**Skaneri virtual**
- Skanerët virtualë: Motorët e skanimit duhet të jenë të disponueshëm për platformat e virtualizimit, duke lejuar integrimin e pandërprerë të skanerit në konfigurimin e virtualizimit.
- Monitorimi: Në mjediset virtuale, krijimi i serverëve të rinj duhet të jetë dinamik. Zgjidhja VM duhet të sigurojë aftësi monitorimi për të skanuar automatikisht serverët virtualë. *Kjo kërkesë është e detyrueshme!*
- Autorizimi: Ofruesit e shërbimeve shpesh e kufizojnë skanimin tek hostet e para-miratuar. Marrja e këtij miratimi do të sjellë një hap shtesë të kërkesës/pritjes në ekzekutimin e programit VM.

**Rezultatet e skanimit duhet të jenë:**
- Gjithëpërfshirës.
- Specifike – veçanërisht në lidhje me të dhënat për zbulimin e cënueshmërisë dhe ofrimin e udhëzimeve për riparim.
- Të shmangë rezultate të rreme (*false positive*) të skanimit (vulnerabiliteti i zbuluar gabimisht) ose rezultate negative të rreme (*false negative*)të skanimit (vulnerabiliteti i pranishëm, por jo i zbuluar).
- Lehtësisht të kuptueshme.

**Zgjidhja e propozuar duhet:**
- Të kenë ndikim minimal në trafik, performancën e serverave, rrjetet informatike etj. gjatë instalimit dhe operimit.
- Të punojë në çdo topologji rrjeti.
- Të mbajë një bazë të dhënash të përditësuar për dobësitë më të fundit.
- Të sigurojë integrime të para-konfiguruara me zgjidhje të tjera sigurie si Splunk, qRadar, etj.
- Të kryejë një skanim të dedikuar (të kontrollojë për një grup të caktuar dobësish ose adresash IP).
- Të suportojë skanimin e aplikacioneve, skanimin e pajisjeve celulare.
- Të suportojë menaxhimin e centralizuar të operacioneve të skanimit, raportimit dhe administrimit.
- Të zbulojë dhe kategorizojë automatikisht asetet bazuar në atribute të shumta dhe jo vetëm në adresat IP.
- Të jetë në gjendje të identifikojë aplikacionet që funksionojnë në porta jo standarde.
- Të gjurmojë hostet me kalimin e kohës në një mjedis dinamik IP (DHCP).
- Të jetë në gjendje të kryejë vlerësimin e cënueshmërisë për të gjitha sistemet operative dhe versionet e tyre duke përfshirë por pa u kufizuar në: serverat Windows, AIX, Unix, Linux, Solaris etj.
- Të sigurojë mekanizma për të ngarkuar listat IP të pajisjeve përmes formatit XLS.
- Të sigurojë politika të konfigurueshme të vlerësimit të cënueshmërisë dhe teste individuale.
- Të jetë në gjendje të skanojë postin e punës, serverat, pajisjet e rrjetit dhe të sigurisë dhe pajisje të tjera si printera, celularë, kamera në internet, tableta etj.
- Të jetë në gjendje të ekzekutojë skanime në segmentet e rrjetit, si dhe në të gjithë rrjetin.

- Të jetë në gjendje të kryejë skanime të autentikuara dhe të paautentikuara, si dhe të menaxhojë kredencialet në mënyrë qendrore për skanime të autentikuara.
- Të jetë në gjendje të skanojë bazat e të dhënave të aplikacioneve për dobësi.
- Të jetë në gjendje të zbulojë fjalëkalimin e dobët për bazat e të dhënave dhe të tregojë llogaritë me fjalëkalime të thjeshta, të dobëta dhe të përbashkëta.
- Të jetë në gjendje të identifikojë versionet e vjetëruara të softuerit, korrigjimet (fix, patch) e aplikueshme dhe përmirësimet e sistemit.
- Të përfshijë metodologjinë e vlerësimit të cënueshmërisë që mund të konfigurohet sipas kërkesave të klientit.
- Të japë informacione korrigjuese në raporte, duke përfshirë lidhjet me korrektimet, etj.
- Të gjenerojë raport që liston të gjitha aplikacionet në një host ose rrjet, pavarësisht nëse aplikacioni është i cënueshëm
- Të jetë në gjendje të suportojë përcaktimin e "dritareve të skanimit", planifikimin e skanimit dhe puazën/ndalimin/rinisjen automatike/manuale të skanimeve.
- Të suportojë përdoruesit për të modifikuar rregullat ekzistuese ose për të krijuar rregullat e tyre.
- Të përfshjë një bibliotekë me dobësi dhe rregulla të mundshme që duhet të suportojnë SANS 20. Kjo bibliotekë duhet të jetë e personalizueshme nga administratorët dhe ndryshimet duhet të jenë të gjurmueshme.
- Tw gjenerohen raporte në formatet si në vijim: XLS, PDF, CSV, XML etj.
- Të ndihmojë në zvogëlimin e numrit të “false positive” të identifikuar nga zgjidhja.
- Të jetë në gjendje të gjurmojë mbylljen e të gjitha dobësive të identifikuara dhe duhet të përfshijë parametra të tillë si personi përgjegjës, data e mbylljes, masat e ndërmarra etj.
- Të gjenerojnë raporte mbi tendencat e dobësive në një aset të caktuar.
- Të jetë në gjendje të integrohet me zgjidhje të tjera sigurie (p.sh. Siguria e Informacionit / Menaxhimi i Ngjarjeve, Menaxhimi i Patch-eve, IDS, IPS, etj.).
- Të ketë një ndërfaqe programimi të aplikacionit (API) për t'u integruar me sisteme të tjera.
- Të suportojë integrimin me burimet e kërcënimeve, duke lejuar që dobësitë të lidhen me informacionin e kërcënimit në kohë reale.
- Të jetë në gjendje të zbulojë si pajisjet ‘wireless’ ashtu edhe ato mashtruese.
- Të suportojë të gjitha llojet e platformave standarde si Solaris, Linux, MAC OS dhe Windows, etj.
- Të sigurojë modele raportesh të parakonfiguruara dhe plotësisht të personalizueshme për palët e ndryshme të interesuara në të gjithë organizatën.
- Të mundësojë raporte të integruara që përfshijnë, por pa u kufizuar në auditimin, krahasimin bazë, përmbledhjen ekzekutive, PCI, pajtueshmërinë e politikave, planifikimin e reagimit, SANS Top 20, raportin e verifikimit të cenueshmërisë etj.
- Të suportojë përditësimet automatike, manuale dhe offline të aplikacioneve.
- Baza e të dhënave të nënshkrimeve të dobësive duhet të përfshijë ndarjen e llojeve të nënshkrimeve (p.sh. CGI, RPC, etj.) dhe numrin e nënshkrimeve që lidhen drejtpërdrejt me ID-të CVE.

## 11.21. Sistemi i Sigurisë së Email (Email Security Gateway)

**Karakteristikat kryesore**

- Zgjidhja duhet të sigurojë:
  - krijimin global të politikave me nivele/shtresore;
  - krijimin e politikave me nivele të bazuara në grupin e përdoruesve;
  - hyrjen e përdoruesit fundor për pamjen e postës në karantinë dhe lëshimin e postës;
  - postën hyrëse të etiketuar "e jashtme" në rreshtin e subjektit;
  - heqjen automatike të etiketës "të jashtme" në rreshtin e subjektit për mesazhet dalëse;
  - integrimin e ndërmjetësit të vërtetimit të bazuar në renë kompjuterike SAML, LDAP, etj.);
- Zgjidhja duhet të ofrojë:
  - mekanizëm për krijimin e fjalorëve të personalizuar si nxitës i politikave/veprimeve;
  - politika specifike të pajtueshmërisë, të cilat mund të personalizohen;
  - politika që kanë fushën "shënime" për komente;

- enkriptim të postës elektronike dalëse të bazuar në politika me përdorimin e portalit special të marrësit - duke siguruar disponueshmërinë e mesazhit pas regjistrimit;
  - mundësinë e përdoruesit përfundimtar për të raportuar postën e padëshiruar (integrimi i veglave të klientit);
  - rrjedhë pune të personalizueshme për mesazhet e padëshiruara të raportuara nga përdoruesit;
  - mesazhe të etiketuara me llojin e sinjalizimit (spam, AV, DLP, etj.);
  - mundësinë e listës së bardhë/listës së zezë globale dhe për çdo përdorues;
  - funksionalitete DLP të selektueshme për kanalin e postës elektronike;
  - filtrim të mashtrimit kundër emrit të domenit (përmban emrin e duhur të domenit);
  - ofrojë filtrim të mashtrimit kundrejt emrit të shfaqur (ndryshon kundrejt adresës MAIL FROM);
  - etiketime specifike të mesazheve të ‘Phish’ dhe ‘Spam’ (të dukshme për përdoruesin fundor;
- Zgjidhja duhet të ketë aftësinë:
  - për të krijuar politika të reja të personalizuara sipas madhësisë së mesazhit, burimit, përmbajtjes, etj.;
  - për të import/eksportuar politika specifike;
  - për të shtuar komente në listën e bardhë/listën e zezë;
  - për të shtuar mesazh (disclaimer) të përgjithshëm për e-mailet dalëse (me parandalim të përsëritjes);
- Zgjidhja duhet të karantinojë DLP tek një pajisje/host i vetëm
- Zgjidhja duhet të akordojë algoritme zbulimi të tipit ‘spearphishing’
- Zgjidhja duhet të ketë DLP të nivelit ‘Enterprise’ (‘Machine Learning’, ‘Fingerprinting’) për kanalin e postës elektronike si pjesë e licencës së ofruar.

**Kërkesat funksionale**

- Zgjidhja duhet të suportojë mundësinë e konfigurimit të serverëve të listës së zezë DNS të palës së tretë për kontrollimin dhe bllokimin e mesazheve hyrëse nga adresat IP të listuara nën bazat e të dhënave përkatëse. Ky opsion duhet të lejojë përcaktimin e një liste përjashtimi.
- Zgjidhja e propozuar duhet të lejojë:
  - Heqjen e titujve të brendshëm për emailet dalëse (maskimi i detajeve të sistemeve të postës elektronike në internet, të tilla si, por pa u kufizuar në, adresa IP dhe emri i hostit, etj.);
  - Futja e mesazheve mohuese për e- mesazhet e postës;
  - Konfigurimin e përgjigjes automatike specifike për adresa specifike dhe atë për emailet hyrëse.
- Duhet të ofrojë njohje optike të imazheve të padëshiruara, duke përfshirë aftësinë për të zbuluar/bllokuar imazhe të vlerësuara për të rriturit.
- Zgjidhja duhet të sigurojë një pajisje opsionale të dedikuar Sandboxing ose ‘instance’ në ‘cloud’, e cila duhet të integrohet me Sigurinë e Email-it nëpërmjet integrimit ‘native’ ose API.
- Duhet të ofrojë një shërbim të shkallëzuar dhe modular, i cili të kujdeset për zgjerimin e ardhshëm të vëllimeve të postës elektronike hyrëse.
- Të filtrojë emailin hyrës bazuar në përmbajtje duke përfshirë bashkëngjitjet. Shërbimi AMP (Anti-Malware-Protection) duhet të ketë aftësi filtrimi të përmbajtjes
- Shërbimi duhet të jetë në gjendje të mbrojë nga emailet e ‘phishing’.
- Të sigurojë që flukset ekzistuese të postës elektronike të mos ndërpriten ose të ndikohen negativisht.
- Të ofrojë aftësi për të menaxhuar, monitoruar dhe mbështetur në mënyrë operative rrjedhën e emailit. Zgjidhja duhet të jetë në gjendje të mbështesë aktivitetet operative.
- Të mundësojë menaxhimin e aftësive të sigurisë së zgjidhjes. Kontrollet e sigurisë mund të menaxhohen dhe konfigurohen nga ekipet operacionale të sigurisë.
- Zgjidhja duhet të mbështesë kontrolle të qarta të aksesit të bazuara në role për qëllime administrative, monitoruese, raportuese, mbështetëse dhe audituese. Shërbimi duhet të lejojë akses granular bazuar në role dhe grupe të përcaktuara me aftësi auditimi.
- Zgjidhja duhet të sigurojë aftësitë e duhura të raportimit operacional duke përfshirë personalizimet p.sh: vëllimi i mesazhit sipas domain-it / përdoruesit / periudhës, etj.
- Zgjidhja duhet të jetë fleksibël për të mbështetur përdoruesin në përputhje me kërkesat rregullatore.

- Zgjidhja duhet të suportojë konfigurimin dhe kontrollin granular administrativ me aftësi auditimi. Shërbimi duhet të ketë konfigurim të hollësishëm dhe aftësi kontrolli duke përfshirë auditimin e ndryshimeve administrative.
- Zgjidhja duhet të sigurojë një ndërfaqe menaxhimi të lehtë për t'u përdorur dhe të këndshme për përdoruesit.
- Shërbimi duhet të ketë në dispozicion marrëveshje licencimi fleksibël.
- Zgjidhja duhet të jetë në gjendje të përpunojë me efikasitet dhe saktësi mesazhet e marra, pavarësisht nga vëllimi, madhësia ose kompleksiteti i politikës.
- Në rast të një dështimi, shërbimi duhet të jetë në gjendje të kalojë pa probleme në sisteme rezervë ‘redundante’ dhe të vazhdojë të përpunojë mesazhe pa ndikim në funksionimin normal.
- Zgjidhja duhet të kryejë regjistrime gjithëpërfshirëse për qëllime të zgjidhjes së problemeve, forenzikës ligjore dhe auditimit. Regjistrat duhet të përmbajnë informacion të detajuar për zgjidhjen e problemeve dhe gjithashtu të ndihmojnë në arritjen e një aftësie të mirë analitike.
- Zgjidhja duhet të suportojë metodat e sigurta të integrimit me SIEM.
- Shërbimi duhet të ketë aftësi anti-spam për të mbrojtur përdoruesit nga emailet e padëshiruara, të cilat përfshijnë spam, përmbajtje për të rritur, etj.
- Zgjidhja duhet të sigurojë një mekanizëm për të prodhuar inteligjencë kërcënimi (threat intelligence).
- Zgjidhja duhet të ketë akses në karantinë dhe aftësi lëshimi për përdoruesit fundorë.
- Të ketë aftësi për të menaxhuar marrësit/dërguesit e mirë dhe të këqij të emailit dhe të filtrojë domenet e emailit bazuar në listat e bardha/të zeza.
- Shërbimi duhet të mbështesë enkriptimin e bazuar në politika.
- Zgjidhja duhet të ketë aftësinë të integrohet me sistemet e menaxhimit të identitetit të klientit dhe t'i përmbahet politikave të menaxhimit të identitetit dhe aksesit të klientit.
- Zgjidhja duhet të mbështesë dërgimin ose vënien në dispozicion të mesazheve në mjete të tjera sigurie për inspektim p.sh: sistemet e analizës së malware.
- Zgjidhja duhet të mbështesë kontrollet e zakonshme të sigurisë së emailit, duke përfshirë SPF dhe DMARC.
- Zgjidhja duhet të projektohet (për aq sa është praktike) për të mbështetur çdo model të ardhshëm të postës elektronike ‘cloud’.
- Zgjidhja duhet të skanojë të gjitha bashkëngjitjet për postë të padëshiruar.
- Zgjidhja duhet të ofrojë aftësi të zbulimit të spamit të bazuar në imazhe.
- Zgjidhja duhet të ofrojë zbulim të spam-it të jashtëm, të vetëdijshëm për përmbajtjen.
- Zgjidhja duhet të krijojë filtra të personalizuar për të identifikuar emailet e padëshiruara.
- Zgjidhja duhet të ketë aftësi specifike për zbulimin dhe ndalimin e sulmeve të synuara (spear) të tipit ‘phishing’.
- Zgjidhja duhet të sigurojë skanim të bazuar në heuristikë.
- Zgjidhja duhet të ofrojë aftësinë për të bërë vërtetimin e marrësit.
- Zgjidhja duhet të ketë aftësi për të kufizuar shpërndarjen e madhësive të bashkëngjitjes si për mesazhet hyrëse ashtu edhe për ato dalëse.
- Zgjidhja duhet të përfshijë njoftimet e dërguara palëve kur emaili nuk dorëzohet për shkak të madhësisë së bashkëngjitjes.
- Zgjidhja duhet të ketë aftësinë për të shënuar emailet ‘bulk’ në mënyrë që përdoruesit të mund të menaxhojnë ato lloj emailesh brenda klientit të tyre të postës elektronike.
- Zgjidhja duhet të ketë të detyruar sigurinë e shtresës së transportit nga serveri në server (TLS).
- Zgjidhja duhet të ofrojë një listë të çdo politike të paracaktuar për çështjet e zakonshme të pajtueshmërisë.
- Zgjidhja duhet të ketë mbështetje të këtyre llojeve të zbulimit; ‘finger print’ të të dhënave të strukturuara, rregullat / shprehjet e rregullta, fjalë kyçe, filigrani, përputhja e saktë e skedarëve/’finger print’.
- Zgjidhja duhet të sigurojë një pamje të radhës së përpunimit (queue) të postës që të mundësojë zgjidhjen e shpejtë të problemeve.
- Zgjidhja duhet të ofrojë aftësi ‘Flexible Logging’. Regjistrimet të jenë të disponueshme minimalisht deri në 90 ditë.
- Zgjidhja duhet të ofrojë trajtim fleksibël të sigurt të postës elektronike, p.sh. "Dërgo në mënyrë të sigurt".

- Zgjidhja duhet të ofrojë klasifikimin dhe etiketimin e të dhënave të përputhshme me Office 365 ; mbrojtja të 'File Share' (email, OneDrive, Skype për Biznes); suport për konfigurimet hibride (p.sh. Office365 dhe Microsoft Office 2016)
- Zgjidhja duhet të suportojë integrim me LDAP.
- Zgjidhja duhet të jetë në gjendje të nënshkruajë DKIM (DomainKeys Identified Mail) të mesazheve dalëse.
- Zgjidhja duhet të jetë e licencuar për 1 vit.

**Email Gateway**

- Zgjidhja duhet të suportojë lidhjet e detyrueshme TLS me domene të jashtme të parakonfiguruara.
- Zgjidhja duhet të ofrojë TLS 'oportuniste' për të gjitha domenet e tjera.
- Zgjidhja duhet të mbajë një histori të të gjitha mesazheve të dërguara/marra - dërguesi, marrësi(ët), koha, subjekti, emri dhe madhësia e bashkëngjitjes etj., si dhe aftësi për të rishikuar gjurmët e auditimit.
- Zgjidhja duhet të ketë aftësinë për t'i përdorur ato të dhëna për të gjurmuar mesazhet bazuar në cilindo nga: dërguesi, marrësi, data/ora, subjekti, lloji/madhësia/emri i bashkëngjitjes, klasifikimi, TLS, informacioni i dorëzimit etj.
- Zgjidhja duhet të zbulojë dhe të investigojë e-mail-et që mbeten jashtë të gjitha klasifikimeve të tjera.
- Zgjidhja duhet të bllokojë/lejojë/ridrejtojë/etj. bazuar në listat e adresave të brendshme/të jashtme, domenet, TLD-të, llojin e bashkëngjitjes, madhësinë e skedarit, kërkimin e SPF DNS, etj.
- Zgjidhja duhet të ofrojë gjurmimin e mesazheve bazuar në vendosjen e 'wildcards' (dërguesi, marrësi, subjekti, data/ora, lloji i bashkëngjitjes etj.).
- Zgjidhja duhet të ofrojë konsiderata të disponueshmërisë së lartë / elasticitetit / rikuperimit nga fatkeqësitë nëpërmjet SLA.
- Zgjidhja duhet të sigurojë:
  - RBAC (role-based access control), mundësisht të lidhur me AD, në ndërfaqen e menaxhimit;
  - qendrën e të dhënave të vendosur në EEA (European Economic Area);
  - mbështetje të detyrueshme TLS për/nga serverët e postës elektronike;

**Instalimi dhe konfigurimi**

- Zgjidhja e propozuar duhet të ketë një opsion për t'u instaluar në formën e harduerit/me pajisje të dedikuar, pajisjes virtuale ose hibride për shembullin 'cloud'.
- Zgjidhja duhet të ofrojë:
  - një zgjidhje të plotë në vend (premise) me mbështetje lokale në dispozicion;
  - një opsion me 'gateway' të shumëfishtë;
  - suport 24/7 nëpërmjet telefonit;
  - një sistem biletash (ticket) incidentesh nga konsola direkt te prodhuesi ose partneri;
- Zgjidhja duhet të sigurojë dokumentacion gjithëpërfshirës të instalimit dhe konfigurimet.

**Regjistrimi dhe monitorimi i alarmeve**

- Zgjidhja duhet të ofrojë:
  - fusha të personalizueshme të regjistrit të sinjalizimeve (vendimi, lloji, veprimi i ndërmarrë, etj.);
  - syslog të regjistrave në sistemin e brendshëm mbi tunelin e koduar;
  - aftësinë 'Syslog';
  - njoftimin e përdoruesit përfundimtar për ngjarjen e karantinës;
  - sistemin e veprimit të karantinës;
  - syslogun e ndryshimeve të konfigurimit që mund të aktivizohet/çaktivizohet;
  - syslogun e përpjekjeve për hyrje të suksesshme/të dështuara;
  - regjistrin e mesazheve të lëshuara;
  - sinjalizime për ndryshimin e konfigurimet;

- sinjalizimet e vëllimit të përpunimit me prag të konfigurueshëm;
- sinjalizime për aktivizimin e rregullave DLP sipas llojit dhe kriticitetit me komente bashkangjitur politikës;
- regjistrin e gjurmëve të auditimit që të gjitha mesazhet të përfshijnë dispozitën;

**Auditimi dhe Raportimi**

- Zgjidhja duhet të ofrojë raporte të volumit të postës sipas kategorive.
- Zgjidhja duhet të sigurojë:
  - planifikimin e raporteve që do të dërgohen me email;
  - personalizimin e raportit për t'u përfshirë sipas llojit të ngjarjes;
  - auditimin e veprimeve të Administratorit (hyrja, shtimet e llogarisë, ndryshimi i fjalëkalimit, ndryshimet e politikave, etj.);
  - integrimin me aplikacione SIEM, si Splunk, etj.;

**Manaxhimi i Sistemit**

- Zgjidhja duhet të ketë aftësinë për të parë radhën e karantinës.
- Zgjidhja duhet të mundësojë kopje rezervë dhe të rivendosë gjendjen e sistemit (konfigurim i plotë).
- Zgjidhja duhet të sigurojë:
  - lëshimin e mesazhit në karantinë;
  - kontrollin e sistemit me konsolë të vetme, të centralizuar;
  - konfigurimin e ciklit të mesazhit në karantinë për të përfshirë periudhën e ruajtjes;
  - konfigurimin e ciklit të mesazhit të dorëzuar për të përfshirë periudhën e ruajtjes së kopjeve;
  - administrimin e përdoruesve me të drejta administrative në sistem;
  - hyrje të shumta të njëkohshme të administratorit;
  - integrimin e autentikimi (single sign-on);
  - konsola të personalizueshme;
- Zgjidhja duhet të ofrojë:
  - qasje në konsolë të bazuar në role (Auditim, Raporte, Super Administrator, Administrator Grupi);
  - provizionimin e përdoruesve fundorë përmes monitorimit të Active Directory;
  - kufizim të hyrjes nga burimi IP (IPV4/IPV6) me aftësi për intervale (multiple ranges);
  - pamje të plotë të çdo mesazhi në karantinë;

**Shtojca 6**

(*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit*)

**FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**

**Sasia e mallit që kërkohet:**

| Nr. | Zëri | Sasia |
|---|---|---|
| 1 | Realizimi i rrjetit fizik (post pune) | 200 |
| 2 | Sistem UPS | 2 |
| 3 | Sistem Storage | 1 |
| 4 | Serverë | 3 |
| 5 | Sistem Backup në kasetë | 1 |
| 6 | Software Backup | 1 |
| 7 | Switch-e SAN | 2 |
| 8 | Sistem Virtualizimi | 1 |
| 9 | Cluster Switch Data Center | 4 |
| 10 | Cluster Switch Access | 5 |
| 11 | Switch Access PoE+ | 1 |
| 12 | Cluster Firewall me IPS, URL Filter | 2 |
| 13 | Firewall për lidhjen e sigurt të Drejtorive | 10 |
| 14 | Kontrollues Wireless | 1 |
| 15 | Access Points | 20 |
| 16 | Sistem për menaxhim aksesi përdoruesish | 1 |
| 17 | Microsoft 365 | 150 |
| 18 | Sistemi AntiVirus | 180 |
| 19 | Sistem per parandalimin e humbjes së të dhënave (Data Loss Prevention) | 180 |
| 20 | Sistemi i menaxhimit të dobësive | 1 |
| 21 | Sistemi i Sigurise së Email | 150 |
| 22 | Implementim, konfigurim, trajnim | 1 |

**Afatet e lëvrimit:**

| Emërtimi i fazës /Periudha kohore (ne muaj) | | M1 | M2 | M3 | M4 | M5 | M6 | M7-M18 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Planifikimi i projektit | x | | | | | | |
| 2 | Lëvrimi i pajisjeve hardware dhe licencave | | x | x | x | x | | |
| 3 | Instalime, konfigurime | | | x | x | x | x | |
| 4 | Testimi | | | | | x | x | |
| 5 | Trajnimi i administratorit | | | | | | x | |
| 6 | Marrja ne dorezim | | | | | | x | |
| 7 | Garancia | | | | | | | x |

Data e fillimit do jetë data e nënshkrimit të kontratës dhe periudha e implementimit të kontratës do jetë 6 muaj duke filluar nga kjo datë.

**Shtojca 7**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

**FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

1. **KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomikt në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkm, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**
1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:
a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**
**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):** Kapaciteti ligjor plotesohet duke dorezuar dokumentat sipas Kritereve te pergjithshme te pranimit/ kualifikimit.

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Kopje te certifikuar te bilancit për vitet financiare 2020, 2021, 2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit nr. 25/2018 ”Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit, te konfirmuar nga administrata tatimore

2.2.2. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit

**2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1.Furnizime te mëparshme të ngjashme në një vlerë jo me te vogel se: 40 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

**Si deshmi per pervojen e meparshme kerkohen te paraqiten:**
Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
**OSE**
Ne rastin e pervojes se meparshme te realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat ISO ose te përditësuara, ose ekuivalente (te vlefshme dhe te akredituara nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

- ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit te cilesise”.
- ISO 20000-1:2011 mbi “Menaxhimin e shërbimit”.
- ISO 22301: 2012 mbi “Krijimin dhe mirembajtjen e vazhdueshme te sistemeve te menaxhimit”.
- ISO 27001:2013 mbi “Sistemet e menaxhimit te sigurise informatike”.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet te paraqes autorizim prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi per pajisjet dhe platformat e kerkuara. Ne rastin e distributorit te autorizuar te paraqitet edhe dokumenti qe verteton lidhjen e distributorit te autorizuar me firmen prodhuese. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: tel, fax, email, ëebsite, kjo e nevojshme per AK ne rast verifikimi nga ana e tij.

2.3.4. Katalog teknik/skede teknike, nga firma prodhuese per pajisjet hardware të kërkuara përkatësisht nr. 2,3,4,5,7,8,9,10,11,12,13,14,15 sipas shtojcës 6 tabela e sasive. Katalogu/skeda teknike te permbaje karakteristikat teknike te pajisjeve si më sipër, qe jane objekt i prokurimit me qellim qe Autoriteti Kontraktor te gjykoje nese malli i ofruar ploteson kerkesat teknike te percaktuara ne dokumentat e tenderit. Ne katalogun/skeden e paraqitur te shenohen ne menyre te dukshme pajisjet si më sipër me specifikimet teknike te kerkuara nga AK. (Pjeset specifike te katalogut ku jepen karakteristikat e mallit qe prokurohet nqs nuk jane ne gjuhen shqipe te perkthehen ne gjuhen shqipe dhe te noterizohen).

2.3.5. Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë e cilësi të kontrates, duhet te kete staf teknik minimalisht 6 (gjashtë) punonjes te diplomuar me arsim të lartë, të certifikuar nga prodhuesit e pajisjeve për produktet e kërkuara sipas shtojcës 6.

Për secin punonjes të paraqiten:

- Diploma e arsimit të lartë përkatëse.
- Listepagesat e shoqerise per te pakten tre muajt e fundit ne te cilat punonjësit e sipërpërmendur duhet te figurojne.

**Shenim:** Për përmbushjen e këtij kriteri operatoret ekonomik ofertues duhet te paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojces nr.8.
Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzoje pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

2.3.6. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë staf teknik te kualifikuar për implementimin e projektit, sipas certifikatave te meposhtme:

- Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar në nivel profesional, për menaxhimin e projektit, ose ekuivalent.
- Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar për zbatimin e infrastrukturës së rrjetit, ose ekuivalent.
- Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar nga prodhuesi për pajisjen e rrjetit të tipit sëitch që do të furnizohet dhe instalohet, ose ekuivalent.
- Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar nga prodhuesi për pajisjen e rrjetit pa tela që do të furnizohet dhe instalohet, ose ekuivalent.
- Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar nga prodhuesi për pajisjet fireëall që do të furnizohen dhe instalohen, ose ekuivalent.
- Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar nga prodhuesi i pajisjes së serverit që do të furnizohet dhe instalohet, ose ekuivalent.
- Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar nga prodhuesi i pajisjeve të ruajtjes që do të furnizohen dhe instalohen, ose ekuivalent.
- Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar nga prodhuesi i sistemit të virtualizimit që do të furnizohet dhe instalohet, ose ekuivalent.
- Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar nga prodhuesi për platformën Microsoft (Microsoft 365, Server, Azure, etj.), ose ekuivalent.

- Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar nga prodhuesi i platformës së menaxhimit të aksesit të përdoruesit, ose ekuivalent.

Pranohen rastet kur një punonjes disponon më shumë se një certifikatë, por që në mënyrë të kombinuar stafi të plotësojë minimumin e certifikatave/dëshmive të kërkuara.

Për secin punonjes të paraqiten:
- Certifikata përkatëse.
- Listepagesat e shoqerise per te pakten tre muajt e fundit ne te cilat punonjësit me certifikatat e sipërpërmendura duhet te figurojne.

**Shenim:** Për përmbushjen e këtij kriteri operatoret ekonomik ofertues duhet te paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojces nr.8.
Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzoje pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

Shtojca 8

*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)*

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I. Unë i nënshkruari ______________ në cilësinë e ________________ të operatorit ekonomik _______ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

| **Identifikimi** | **Përgjigjja** |
|---|---|
| Emri i operatorit ekonomik:<br>(Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE | ------------------------------------------------ |
| Numri NIPT/et: | --------------------------------------------------- |
| Adresa postare:<br>Qyteti / qyteti; Kodi postar | ------------------------------------------------------ |
| Përfaqësuesi (emri): | -------------------------------------------- |
| Telefoni: | ----------------------------------------------------- |
| E-mail: | ------------------------------------------------------- --- |

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

| |
|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:<br><br>• **Informacione për nënkontraktorin** |

| Emri i nënkontraktorit të propozuar | NIPT – i | Përqindja e nënkontraktimit | Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

| Emri (at) e subjekteve | NIPT-i | Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik | Specifiko konkretisht kapacitetin/et |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

**Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**

**A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**

| **Deklarata** |
|---|
| Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ____________________________________________________ |
| Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ___________________________________________________ |

______________________________________________________

| |
|---|
| Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: ______________________________________________________ ______________________________________________________ etj.<br>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ___________________________________________________ |
| Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ___________________________________________________ |
| Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ___________________________________________________ |
| Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.<br>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* |
